

ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL PËR MËSUESIT E ARSIMIT PROFESIONAL NË SHQIPËRI

Në Shqipëri ekziston një angazhim i qartë politik përse i përket zhvillimit të vazhdueshëm profesional (ZHVP) të mësuesve dhe trajnuesve të arsimit profesional, e shprehur edhe në SKPA 2014–2020.

Zbatimi i strategjisë është në vazhdim e sipër, nëpërmjet programeve pilot për mësuesit dhe edukatorët e arsimit profesional. Organizatat dhe institucionet e përfshira në ofrimin dhe në konceptimin e programeve për ZHVP janë të pakta në numër dhe në shumëllojshmëri. Programe të tilla ofrohen nga një universitet publik në Korçë dhe disa ofrues privatë të akredituar nga Instituti për Zhvillimin Arsimor (IZHA), por ato nuk ofrojnë ZHVP posaçërisht për mësuesit e arsimit profesional. Shumica e aktiviteteve për trajnimin e specialistëve organizohen dhe mbështeten (teknikisht dhe financiarisht) nga projektet e donatorëve.

Gjatë periudhës 12 mujore para anketës, 42% e mësuesve të arsimit profesional kishin marrë pjesë në evente për ZHVP jashtë shkollës dhe 38% në evente të organizuara në shkollë. Vetëm 23% kishin marrë pjesë në ZHVP që lidhej me specializimin e tyre profesional.

Disa shkolla kanë përfituar nga projektet e donatorëve, të cilat kanë organizuar dhe zbatuar një numër të konsiderueshëm trajnimesh për grupe të caktuara mësuesish të arsimit profesional. Shumica e mësuesve dhe instruktorëve profesionalë në shkolla nuk kanë marrë asnjë lloj trajnimi pedagogjik. Kjo po adresohet nëpërmjet një programi të pilotuar nga AKAFPK me mbështetjen e GLZ, i cili duhet të shtrihet tek të gjithë mësuesit dhe instruktorët profesionalë sipas Udhërrëfyesit të publikuar.

Shumica e organizatave që ofrojnë ZHVP kanë njohuri teknike (*know-how*) dhe kapacitet të kufizuar për të ofruar apo konceptuar ZHVP që adreson nevojat specifike profesionale të mësuesve dhe trajnuesve profesionalë, p.sh. njohuri bashkëkohore në lidhje me praktikën aktuale industriale dhe me mënyrën e zhvillimit të aftësive praktike.

Punëdhënësit kanë pak ose aspak përfshirje në formulimin apo akreditimin e ZHVP për mësuesit profesionalë. Pothuajse të gjithë aktorët e kanë pranuar që monitorimi - dhe më në përgjithësi sigurimi i cilësisë së sistemit të ZHVP- mungon.

Disa shkolla profesionale organizojnë dhe kryejnë ZHVP për stafin e tyre, për shembull, nëpërmjet vëzhgimit, mbështetjes nga të ngjashmit, seancave për trajnimin e stafit. Rreth 38% e mësuesve profesionalë kanë raportuar që, gjatë 12 muajve të fundit, i janë nënshtruar trajnimit në shkollë, por vetëm 17.5% raportuan ndjekjen e këtij trajnimi për

më shumë se 30 orë. Ekzistojnë ndryshime të mëdha nga njëra shkollë në tjetrën: bashkëpunimi dhe puna e përbashkët e mësuesve janë të organizuara më mirë në shkollat më të mëdha dhe në shkollat e mbështetura nga projektet e donatorëve.

Në Shqipëri, ekziston një kërkesë formale për shkollat profesionale që të identifikojnë nevojat dhe t'i paraqesin kërkesat për trajnim bazuar në këto plane. Megjithatë, ky proces nuk zbatohet në mënyrën e duhur dhe nuk shërben si shtysë për konceptimin dhe ofrimin e trajnimit.

Sipas anketës rreth 50% e mësuesve profesionalë raportuan nevojën për një lloj të veçantë të ZHVP, të cilin nuk e kanë marrë gjatë 12 muajve të fundit.

Përveç kësaj, 49% e mësuesve profesionalë kanë raportuar që ZHVP që ju është ofruar nuk është relevant. Aktualisht ekziston një projekt pilot për trajnimin e drejtuesve në shkolla të përzgjedhura profesionale për të marrë përsipër kryerjen e analizës së nevojave dhe për të planifikuar trajnimin në shkollat e tyre. Në shkollat profesionale ekzistojnë procedurat për orientimin fillestar (*induction*) të mësuesve të rinj dhe në përgjithësi këto procedura zbatohen. Nga na tjetër, mentorimi nuk konsiderohet si një pjesë formale e sistemit të AFP. Shkollat profesionale ose institucionet i ushtrojnë ato vetëm në disa raste të pakta. Nuk ekzistojnë trajnime të veçanta për mentorët profesionalë dhe statusi i tyre nuk është i rregulluar ashtu siç duhet.

Nuk ekzistojnë agjenci të sektorit publik përgjegjëse për mbështetjen e trajnimit të trajnerëve që punojnë në kompani ose në qendrat e formimit. Interesi i biznesit për arsimin dhe formimin është në rritje dhe ekzistojnë edhe disa nisma. Zhvillimi i rolit të koordinatorëve arsim-biznes në shkolla (PASO) përbën një mundësi kyçe.

Rekomandimet e përzgjedhura

1. Finalizimi i kuadrit ligjor për zhvillimin profesional (dhe arsimin fillestar) për mësuesit dhe instruktorët profesionalë, duke marrë në konsideratë rolin e mentorëve, me konsultimin paraprak të palëve të interesuara për të siguruar zbatimin.
2. Caktimi i përgjegjësive për AKAFPK si organi kombëtar përgjegjës për hartimin e një koncepti gjithëpërfshirës dhe për koordinimin e analizës, zhvillimit dhe zbatimit të një programi kombëtar për zhvillimin profesional dhe akreditimin për mësuesit dhe

instruktorët profesionalë.

3. Ofrimi i legjislacionit sekondar dhe i financimit për njësitë e shkollave përgjegjëse për zhvillimin profesional.

Kjo është një përmbledhje e një ushtrimi lokalizimi i kryer në vitin 2015. Të dhënat janë nxjerrë nga një anketë për 227 mësues profesionalë, nga intervista, nga rishikimi i literaturës dhe nga një seminar.

Shih raportin në faqen e internetit të ETF: **www.etf.europa.eu**
@ European Training Foundation, 2016